

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, gjyqtarëve Qerim Ademaj dhe Rafet Haxhaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit/propozuesit NTMP "[S...]" Sh.p.k., me seli në Preshevë, të cilën me autorizim e përfaqëson [E.Q] avokat nga Gjilani, kundër të paditurit/kundërshtarit të sigurimit "[N...]" sh.p.k., me seli në Prishtinë, me pronar [Z.L], të cilin me autorizim e përfaqëson [A.O], avokat nga Prishtina, duke vendosur sipas ankesës së kundërshtarit të sigurimit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti për Çështje Ekonomike, III.Ek.nr.151/15, të datës 29.08.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 13.10.2017 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kundërshtarit të sigurimit "[N...]" sh.p.k., ndërsa Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, III.Ek.nr.151/15, të datës 29.08.2017, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar gjykata e shkallës së parë e ka miratuar propozimin e propozuesit të sigurimit/paditësit NTNP "[S...]" Sh.p.k., për caktimin e masës së sigurimit, dhe ka caktuar masën e sigurimit me të cilën kundërshtarit të sigurimit "[S...]" Sh.p.k., i ka ndaluar që të disponojë me mjetet e veta monetare që i ka nëpër bankat komerciale në Kosovë, duke i bllokuar të gjitha llogarit e sajë bankare vetëm deri në shumën prej 20,000.00 euro.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kundërshtari i sigurimit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoje ankesën në tërësi si të bazuar dhe të prishet aktvendimi i atakuar, dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, aktvendimit të atakuar dhe shkresave të lëndës në pajtim me nenin 194 në lidhje me nenin 208 të LPK, Gjykata e Apelit ka gjetur :

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesi/paditësi me datë 31.03.2015, në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar padi më të cilën ka kërkuar aprovimin e kërkesëpadisë dhe atë që i padituri ti dorëzojë menjëherë makinën blerëse, sitën për sitjen e rërës me NR.motori "[...]" i vitit të prodhimit 2006, duke propozuar edhe caktimin e masës së përkohëshme të sigurisë ashtu që ndaj sendit të vendoset shiriti sigures që të mos afrohen personat e tjerë me qëllim të dëmtimit ose largimit në vend tjetër të sitës për sitjen e rërës.

Gjykata e shkallës së parë pas kundërshtimit të bërë nga i paditurit/kundërshtari i sigurimit kundër aktvendimit për caktimin e masës së përkohëshme të sigurisë ka caktuar seancë me datën 29.08.2017. Në këtë seancë paditësi/propozuesi i masës së sigurisë ka bërë precizimin e propozimit për caktimin e masës së sigurisë ashtu që ka kërkuar bllokimin e xhirillogarive bankare në Bankat Komerciale të Kosovës, të kundërshtarit të sigurimit, për shkak se objekti mbi të cilën ka kërkuar caktimin e masës së përkohëshme të sigurisë është shitur në Maqedoni, andaj propozimi është bërë i besueshëm bazuar në provat e bashkangjitura të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Përfaqësuesi i përkohëshëm i të paditurit/kundërshtarit të sigurimit në seancën e mbajtur ka kundërshtuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet e para me nenin 297 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në këtë gjendje të çështjes me aktvendimin e atakuar III.Ek.nr.151/15 të datës 30.08.2017, e ka aprovuar në tërësi si të bazuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë ndaj të paditurit/kundërshtarit të sigurimit, duke vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me Nenin 297 par.1, të LPK-së.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkëlqje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK e po ashtu drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore i vështron gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata e apelit e mori këtë vlerësim juridik për arsye se sipas Nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se:” *Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së kështillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.*

Në rastin konkret, propozuesi ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit për realizimin e të drejtave të tij dhe nga shkresat e lëndës rrjedh se ka ofruar prova të mjaftueshme për të argumentuar se janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës siguroese të parapara me Nenin 297 par. 1 pika a) dhe b) të LPK-së. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi/propozuesi ka kryer pagesën në bazë të faturës, me NR.11-1/2015, e vërtetuar sipas urdhërpagesës së datës 27.02.2015 e cila është bërë përmes TEB bankës në Prishtinë, në llogari të të paditurit/kundërshtarit të sigurimit “[N...]”, Sh.k.p, nga çka rrjedh se paditësi/propozuesi e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive. Po ashtu në rastin konkret plotësohet edhe kushti i dytë ligjor për caktimin e masës së sigurimit sepse paditësi/propozuesi i masës së sigurimit ka ofruar prova të mjaftueshme se pa caktimin e masës së sigurisë pala kundërshtare do të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me

ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Gjykata e Apeli i vlerësojë si të pabazuara pretendimet ankimore të kundërshtarit të propozimit, sepse të njëjtat janë kontradiktore ndërmjet vete dhe në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, al.1 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ae.nr.240/2017, me dt. 13.10.2017

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Mahir Tutuli, dv.

